

Infektive virale



Egzantema Virusale (Pezmatime Të Shoqëruara me Virusë)

Hyrje

Infektimet virale janë të zakonshme te foshnjat dhe fëmijët e vegjël. Ata zakonisht shkaktojnë pezmatime të lëkurës jo shumë të theksuara. Pezmatimet mund të paraqiten në forma të ndryshme, si njolla të kuqe të rrafshta ose me shumë puçrra të vogla të ngritura, fshikëza, blanë ose si kombinim i të gjitha formave.

Virusë të llojeve të ndryshme mund të shkaktojnë pezmatime të ndryshme në lëkurë, megjithatë ndonjëherë virusë të ndryshëm mund ta shkaktojnë të njëjtin pezmatim. Në tekstin e mëposhtëm përshkruhen disa lloje të infektiveve të zakonshme virale të shoqëruara me pezmatime të lëkurës. Këto sëmundje të lëkurës janë infektive dhe shpërndahen me kontakt të drejtëpërdrejtë.

Rozeolla Fëmijënore

Ky infektim viral është sëmundje më e zakonshme e lëkurës që shkakton ethe te fëmijët e moshës nën dy vjeç. Zakonisht paraqitet në moshën rreth 6-9 muaj. Ethet të përcjella me temperaturë prej 39-40 C nisin befas, dhe zgjasin 3-5 ditë. Fëmiu përndryshe ndihet mirë me përjashtim të një shqetësimi të vogël. Gjëndrat rreth qafës zmadhohen dhe kur temperatura nis me zbrit, në qafë dhe trup paraqiten njolla ngjyrë rozë -vjollcë. Njollat mund të shpërndahen nëpër duar, fytyrë dhe këmbë mbrenda 1-2 ditëve. Ato nuk janë të kruashme. Mjekimi për këtë gjendje nuk është i nevojshëm.

Sëmundja e lëkurës në Duar, Këmbë dhe Gojë

Te fëmijët e vegjël ky infektim viral paraqitet zakonisht në stinën verore dhe në vjeshtë. Infektimi i këtij lloji nuk është i njëjtë me infektimin viral që shkakton sëmundjen 'të gojës dhe këmbëve (sëmundja e tërbimit të shtazve) te shtazët e fermave. Simptomet, te fëmijët janë zakonisht të buta dhe zgjasin rreth 7 ditë, fillimisht me ethe të lehta. Në gojë zhvillohen fshikëza që shpesh shpërthejnë të formojnë ulcerë të vegjël. Fshikëzat e vogla ngjyrë hiri si margaritari kanë formë ovale, pjesa e skajshme e të cilave është e skuqur, mund të zhvillohen në gishtërinjë të dorës dhe të këmbës dhe rreth pjesëve anësore të shputave. Numri i fshikëzave ndryshon dhe ato zhduken mbrenda 2-3ditëve. Fshikëzat nuk janë të kruarshme dhe nuk dhëmbin. Mjekimi nuk është i nevojshëm.

Erithema Infektive (Faqe e shuplakët ose Sëmundje e Pestë)

Shpërthime të vogla të këtij infektimi viral zhvillohen kah stina e pranverës dhe shumica e rasteve manifestohet te fëmijët e moshës rreth 2-10 vjeç. Sëmundja zhvillohet në faqe, të cilat bëhen shumë të nxehta dhe skuqen (prandaj dhe ka marrë emrin ' sëmundje e faqeve të shuplakura'). Kjo sëmundje zhvillohet mbrenda 24 orëve, dhe nëse përcjellet me ethe /zjarrmi , ato janë zakonisht të buta. Skuqja mund të shpërndahet në trup në forma si

Albanian – Viral Exanthems (Rashes Associated with Viruses)

me dantella. Zakonisht skuqja shuhet mbrenda 6-10 ditëve. Pastaj, nëse trupi i fëmiut nxehet ose nëse është në ambient me diell, skuqja prap mund të paraqitet nëpër duar dhe këmbë mbrenda dy javëve të ardhëshme. Për këtë lloj të infektimit, nuk nevojitet mjekim.

Fruthi

Tani, falë imunizimit, fruthi fare pak zhvillohet. Megjithatë, nuk është plotësisht i shlyer nga komuniteti. Simptomët e para të paraqitjes së fruthit janë ethet/zjarrmi, kollitja, skuqja dhe rrjedhja nga hunda, dhimbja e syve, të gjitha zgjasin 3-5 ditë. Përgjithësisht fëmiu ndihet i sëmurë, ka mungesë të energjisë dhe ka shqetësime. Ditën e dytë nga nisja e infektimit, në mbrendi të faqeve paraqiten njolla të bardha si në blu me rreth të kuq. Ditën e katërt, skuqja e lëkurës zhvillohet te balli dhe prapa veshëve, duke u shpërndarë mbrenda 24 orëve në pjesë tjera të fytyrës dhe në trup. Një javë më pas, skuqja nis të shuhet duke lënë pas njollë si ngjyrë kafe në lëkurë, që mund të qërohet. Në pjesën dërmuese të rasteve, infektimi qetësohet plotësisht pa komplikime të mëdha. Për këtë infektim nuk ka ndonjë trajtim specifik, por fëmiu duhet shtrirë në shtrat ose të pushon, ndërkohë duhet pirë uj me sasira të mjaftuara dhe duhet evituar dritën e fortë. Për qetësimin e etheve/zjarrmit fëmijë të moshave të herëshme mund tu jipet paracetamolqë i përgjigjet moshës së tyre.

Informata të Mëtejme

Infermijerja e Qendrës Për Shëdetin e Nënës dhe Fëmiut
Farmacisti i juaj
Mjeku i juaj
Dermatologu